

VENDIM
Nr. 62, datë 8.4.2020

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ERA HYDRO” SHPK, NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “STORI”, ME KAPACITET TË
INSTALUAR 2000 kw**

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe të nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; dhe të nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 8.4.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Era Hydro’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- ERE, me vendimin nr. 15, datë 23.1.2020, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Era Hydro” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Stori”.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në medien e shkruar, me shkresën nr. 62/3, datë 27.1.2020, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Era Hydro” sh.p.k.

- Me shkresat nr. 292 prot., datë 28.1.2020 dhe nr. 292/1 prot., datë 28.2.2020, ERE iu drejtua shoqërisë, duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “Era Hydro” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 17/1 prot., datë 26.2.2020 dhe së fundmi me shkresën nr. 292/2 prot., datë 30.3.2020, ka përcjellë dokumentacionin e munguar dhe dokumentacionin tjetër plotësues për qëllime të aplikimit për licencim.

- Nga aplikimi u konstatua se kontrata nr. 16 rep. dhe nr. 12/3 kol., datë 5.1.2018, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit ‘Stori’, me kapacitet prodhues 2 mw, në përroin e Holtës dhe të Seltës, degë e lumit Devoll, Bashkia Gramsh, qarku Elbasan”, është lidhur midis mbajtësit të miratimit shoqërisë “Era Hydro” sh.p.k. dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për një afat 49-vjeçar, që fillon nga data e hyrjes në fuqi të saj, me të drejtë ripërsëritjeje.

- Hidrocentrali “Stori” do të shfrytëzojë ujërat e përrënjeve të Holtës dhe të Seltës, degë të Lumit Devoll dhe do të ketë dy vepra marrjeje. Parametrat e pasqyruar në “Projektin e zbatimit” për këtë HEC janë të njëjtë me ata të pasqyruar në “Raportin e oponencës teknike” dhe kontratën nr. 16 rep. dhe nr. 12/3 kol., datë 5.1.2018, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Stori”, me kapacitet prodhues 2 mw, në përroin e Holtës dhe të Seltës, degë e lumit Devoll, Bashkia Gramsh, qarku Elbasan”.

- Shoqëria ka përcjellë në ERE kontratën e qirasë nr. 7413 prot., datë 26.10.2017, “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor kullësor publik”, me palë Bashkinë Gramsh dhe shoqërinë “Era Hydro” sh.p.k. Qëllimi i kontratës është ushtrimi i veprimtarisë për ndërtimin e HEC “Stori”. Afati i kësaj kontrate është 10 vjet me të drejtë rinovimi. Kjo kontratë i fillon efektet ligjore dhe financiare në momentin e pajisjes së subjektit me leje ndërtimi.

- Shoqëria ka përcjellë në ERE “Miratimin e pikës së lidhjes së HEC ‘Stori’ të shoqërisë ‘Era Hydro’ sh.p.k”. Ky miratim është dhënë për HEC “Stori”. Po ashtu, shoqëria ka depozituar edhe marrëveshjen e lidhjes së re të lidhur midis OSHEE sh.a. dhe “Era Hydro” sh.p.k. në rrjetin elektrik të shpërndarjes. HEC “Stori” do të lidhet në nënstacionin elektrik HEC “Cërrunjë”.

- Shoqëria ka paraqitur lejen e Këshillit të Basenit Ujor Seman, “Për përdorim të Burimit Ujor”, me nr. 00083 seria, nr. 1072/1 prot., datë 30.11.2017 dhe nr. vendimi 24, datë 16.11.2017, lëshuar për shoqërinë “Era Hydro” sh.p.k., për prodhim energjie elektrike, duke përdorur burimin ujor të Përroit të Holtës, degë e lumit Devoll. Në këtë leje janë pasqyruar koordinatat e zonës ku do të shtrihet veprimtaria, si dhe sasia e prurjeve mesatare për secilën vepër marrjeje. Periudha e vlefshmërisë së kësaj leje është deri në datën 16.11.2022, me të drejtë rinovimi.

- Parametrat e sipërcituar janë të njëjtë me ata të pasqyruar në “Raportin e oponencës teknike” dhe kontratën nr. 16 rep. dhe nr. 12/3 kol., datë 5.1.2018, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit ‘Storri’, me kapacitet prodhues 2 mw, në përroin e Holtës dhe të Seltës, degë e lumit Devoll, Bashkia Gramsh, qarku Elbasan”.

- Shoqëria ka depozituar në ERE shkresën nr. 940 prot., datë 18.4.2017, të Ministrisë së Mjedisit, VNМ-në paraprake, me nr. vendimi 16 dhe nr. identifikimi 258, të lëshuar për “Era Hydro” sh.p.k., për ndërtimin dhe operimin e HEC “Storri”.

- Shoqëria ka depozituar në ERE kontratën e kredisë bankare të përgjithshme nr. 2965 rep., nr. 1285 kol., datë 7.6.2019, me anë të së cilës aplikuesi, ka marrë kredi, me qëllim të vetëm investimin e HEC “Storri”. Shoqëria ka depozituar në ERE, gjithashtu, edhe disa kontrata huaje, që së bashku me kredinë mbulojnë tërësisht vlerën e investimit të parashikuar në planin e biznesit të kontratës së koncesionit.

- Aplikuesi merr përsipër të vërë në punë hidrocentralin brenda 21 muajve nga data e marrjes së të gjitha lejeve për fillimin e punimeve.

Nga analiza e dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “Era Hydro” sh.p.k., rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”: plotësuar;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”: plotësuar;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c”, “d”: Plotësuar;
- dokumentacioni teknik për HEC-in, neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, germat “a”, “b”, “c”, “d” dhe pika 4.1.4, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”: plotësuar;
- Leje nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.1.5, germat “a”, “b”, “c”: plotësuar.

ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe të nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të gjatë se 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Era Hydro” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Storri”, me kapacitet të instaluar 2000 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria të depozitojë në ERE, jo më vonë se 1 muaj para përfundimit të saj, kontratën e qirasë për truallin ku do të ushtrohet veprimtaria, të rinovuar.

3. Shoqëria të depozitojë në ERE, jo më vonë se 1 muaj para përfundimit të saj, lejen “Për përdorimin e burimit ujor”, të rinovuar.

4. Mosplotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti